




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 290/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Telekomi i Kosovës” SH.A. – Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: “Shërbimet e Telefonisë mobile për nevojat e NPL-së” me nr. prokurimit: 19-3570-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Stacioni i Autobusave” SH.A. më datën 23.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Telekomi i Kosovës” SH. A. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e Telefonisë mobile për nevojat e NPL-së” me nr. prokurimit: 19-3570-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Stacioni i Autobusave, SH. A. Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për kontratë i AK -së Stacioni i Autobusave ”SH.A. lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Shërbimet e Telefonisë mobile për nevojat e NPL-së” me nr. prok.: 19-3570-2-3-6.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Telekomi i Kosovës" SH.A.– Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë: 27.05.2019; Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kuotim-Shërbime; Vlera e parashikuar e kontratës: 7.500,00 €; Kriteri për dhënie të kontratës (N.52) tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët; Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 05.06.2019; Data e hapjes së ofertave: 05.06.2019; Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave: 06.06.2019; Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm: 06.06.2019; Data e njoftimit për pezullimin e aktivitetit të prokurimit: 07.06.2019; Data e kërkesës për rishqyrtim: 30.05.2019; Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: 30.05.2019.

Operatori ekonomik ankues "Telekomi i Kosovës" SH.A.– Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 07.06.2019 nr. 290/19, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e Telefonisë mobile për nevojat e NPL-së" me nr. prokurimit: 19-3570-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Stacioni i Autobusave" SH.A. Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 9.4 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.06.2019 autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 24.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të grupit të OE ankues "TELEKOMI I KOSOVËS" Sh.A
Përgjigje në Pretendimin

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Telekomi i Kosovës" Sh.A se AK "Stacioni i Autobusëve" Sh.A nuk ka zbatuar Nenin 9.4 të LPP-së "Përcaktimi i nevojave që duhet të përmbushën" me rastin e inicimit të procedurës së prokurimit që për objekt të aktivitetit kishte "Shërbime të telefonisë mobile për nevoja të NPL-së" duke pretenduar nga OE ankues që këto nevoja/shërbime janë në dispozicion të autoritetit publik "Telekomi i Kosovës" dhe ky aktivitet i prokurimit i iniciuar nga AK "Stacioni i Autobusëve" duhet të anulohet sepse ky shërbim ofrohet nga Autoriteti publik "Telekomi i Kosovës" konform LPP-se, Neni 9.4, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti Kontraktues parase fillimit të procedurave të prokurimit duhet të vlerësoj/hulumtoj se nevojat/shërbimet për të cilat do të procedohet aktiviteti i prokurimit a përmbushen nga ndonjë autoritet tjetër publik konform neni 9.4 të LPP_së.

Konsiderojmë që pretendimi i OE është plotësisht i bazuar dhe me rastin e "Kërkesës për Rishqyrtim" pretendimin e shprehur nga OE ankues AK është dashur ta merr për bazë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues në këtë rast apo edhe në raste të ngjashme KRPP ka dhënë një interpretim ku citohet:

Duke marr për baze dilemat e shfaqura te Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta te tyre (drejtuar KRPP-es) qe te behet e qarte se si duhet te veprohet ne rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevojapër sigurim te shërbimeve te cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik?

Konform neni 87, paragrafit 2, nenparagrafit 2.8 te Ligjit Nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L -042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si ne vijim:

Sa i përketçështjes së parashtruar me larte, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese qe te veprojnë si ne vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tille publik duhet te marre masa te arsyeshme për tu siguruar se lendet qe i përmbushinkëto nevoja nuk janë ne dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.

Pra neni i lartecituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojapër sigurimin e shërbimeve operator i te cilave po ashtu ështënjë autoritet publik.

LPP,nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre (ne mes vete) meqë kjo ështëçështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.

Mirëpoështë mese e qarte se këto raste kane te beje me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit qe rregullon prokurimin publik kur një forme e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund te kërkojë ofrimin e një shërbimi ne shërbente e tij ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuarndonjë procedure tenderimi, te ashtuquajtura përjashtim " ne shtëpi).

Si përfundon pas analizimit te cekur me larte (neni 9.4 te LPP-se) dhe te kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozite tjetër te LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike qe te marrin masa për te mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-ës, neni 12.1) KRPP nuk ka se si te mos e trajtoje ketëçështje ashtu sikur është vendosur ne nenin 9.4 te LPP-se.

KRPP, nuk do te publikoj asnjë lloji Njoftimi (Njoftimi për kontrate, Njoftimin për dhënie apo për nënshkrimin e kontratës) dhe do te deklaroj aktivitetet; vendimet dhe/ose kontratat jo ligjore ne rast se nuk janë respektuar dispozitat e cekura me larte apo cila do dispozite tjetër e legjislacionit për prokurim publik

Bazuar edhe në interpretimin e KRPP-se konsiderojmë pretendimi i OE ankues është i bazuar dhe AK "Stacioni i Autobusëve"Sh.A duhet ta anuloj aktivitetin e prokurimit/Njoftimin për dhënieje të kontratës dhe të konsultohet me Ministrinë e Administratës Publike e cila ka një kontratë të ngjashme me "Telekomin e Kosovës" për shërbime të ngjashme nëse ka hapësira ligjore që të përfshihet në këtë kontratë edhe AK "Stacioni i Autobusëve"Sh.A

Konstatojmë se pretendimi ankimor është i bazuar

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të pranohet për arsyen që i theksuam në përgjigjeje të pretendimit ankimore të më sipërm.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta ANULOJ aktivitetin e prokurimit "Shërbime të telefonisë mobile për nevoja të NPL-së" me nr.prokurimi 19-3570-2-3-6 të iniciuar nga AK-"Stacioni i Autobusëve"SH.A Prishtinë.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim brenda afatit ligjor nuk ka kthyer përgjigje për ta njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohetapo jo me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues senuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues profesional, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues, përfaqësuesi i AK- "Stacioni i Autobusave"SH.A, Telekom i Kosovës"SH.Au shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi iOE ankues z. Prebreza deklaroj: Unë si operator ekonomik Telkomi omi qëndron prapa ankesës gjithashtu pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues profesional dhe duke u bazuar ne pretendimet tona edhe ne vendimet e OSHP-se kërkojmë qe ky PA te anulohet

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi AK-së z. Vokrri deklaroj: ne si Autoriteti Kontraktues ne propozimin e Eksperti Shqyrtues. Për anulimin e AP u pamundësohet OE tjerë te barabarte. Ne bazë te dëshmive te ofruar nga OE i licencuar nga Autoriteti rregullativ për te ofruar shërbime telefonik fikse dhe internet ne mendojmë qe OE është i barabartë me te gjithë OE te tjerë, fakti qe neni 9.4 i LPP-së ka marr vetëm konceptin e bashkëpunimit publiko publik dhe jo edhe kriteret e mire te caktuara te direktivave te BE-se te MSAS ne bazë te mos diskriminimit dhe te reciprocitetit dhe te mos ketë favorizime.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Papaj deklaroj: Unë si ekspert shqyrtues mbës prapa ekspertizës time qe ky AP te anulohet dhe kam sugjeruar AK qe te konsultohet me Administratën publike, sa i përket ankesës se OE neni 9.4 është shume i qartë ku thuhet " nëse Autoriteti Kontraktues është autoritet publik autoriteti publik duhet te merr masa te arsyeshme për lendet qe i përmbushin këto nevoja nuk janë ne dispozicion nga ndonjë tjetër Autoritet tjetër publik" Ankesa e Telekomit është e bazuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë qe te aprovohet ankesa jone.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: kërkojmë të refuzohet ankesa e OE dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, ne vijim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE ankues “TELEKOMI I KOSOVËS” Sh.A.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Telekomi i Kosovës” Sh.A se AK “Stacioni i Autobusëve” Sh.A nuk ka zbatuar Nenin 9.4 të LPP-së “Përcaktimi i nevojave që duhet të përmbushën” me rastin e inicimit të procedurës së prokurimit që për objekt të aktivitetit kishte “Shërbime të telefonisë mobile për nevoja të NPL-së” duke pretenduar nga OE ankues që këto nevoja/shërbime janë në dispozicion të autoritetit publik “Telekomi i Kosovës” dhe ky aktivitet i prokurimit i iniciuar nga AK “Stacioni i Autobusëve” duhet të anulohet sepse ky shërbim ofrohet nga Autoriteti publik “Telekomi i Kosovës” konform LPP-se, Neni 9.4. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se Autoriteti Kontraktues para fillimit të procedurave të prokurimit duhet të vlerësoj/hulumtoj se nevojat/shërbimet për të cilat do të procedohet aktiviteti i prokurimit a përmbushen nga ndonjë autoritet tjetër publik konform neni 9.4 të LPP- së. Konsiderojmë që pretendimi i OE është plotësisht i bazuar dhe me rastin e “Kërkesës për Rishqyrtim” pretendimin e shprehur nga OE ankues AK është dashur ta merr për bazë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues në këtë rast apo edhe në raste të ngjashme KRPP ka dhënë një interpretim ku citohet:

Duke marr për baze dilemat e shfaqura te Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta te tyre (drejtuar KRPP-es) qe te behet e qarte se si duhet te veprohet ne rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevoja për sigurim te shërbimeve te cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik?

Konform neni 87, paragrafit 2, nen paragrafit 2.8 te Ligjit Nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L -042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si ne vijim:

Sa i përket çështjes së parashtruar me larte, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese qe te veprojnë si ne vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për të siguruar se lëndet që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.

Pra neni i lartecituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevoja për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik.

LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritetet publike do të rregullojnë plotësimin e nevojave të tyre (në mes vete) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.

Mirëpo është mese e qarte se këto raste kanë të bëjë me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbente të tij ose shërbimeve të një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim "në shtëpi").

Si përfundon pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-se) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-ës, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP-se.

KRPP, nuk do të publikoj asnjë lloji Njoftimi (Njoftimi për kontratë, Njoftimin për dhënie apo për nënshkrimin e kontratës) dhe do të deklaroj aktivitetet; vendimet dhe/ose kontratat jo ligjore në rast se nuk janë respektuar dispozitat e cekura më lartë apo cila do dispozitë tjetër e legjislacionit për prokurim publik

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional nga sqarimet e dhëna si më lart si dhe duke u bazuar edhe në interpretimin e KRPP-se konstaton se pretendimi i OE ankues është i bazuar dhe AK "Stacioni i Autobusëve" Sh.A duhet ta anuloj aktivitetin e prokurimit/Njoftimin për dhënie të kontratës dhe të konsultohet me Ministrinë e Administratës Publike e cila ka një kontratë të ngjashme me "Telekomin e Kosovës" për shërbime të ngjashme nëse ka hapësira ligjore që të përfshihet në këtë kontratë edhe AK "Stacioni i Autobusëve" Sh.A

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh faktin që Telekom i Kosovës është autoritet publik dhe ofron shërbime profesionale të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit, dhe duke pasur parasysh faktin që AK Stacioni i autobusëve SH.A Prishtinë, si autoritet kontraktues nuk e ka respektuar nenin 9.4 të LPP-së, atëherë ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet dhe të merret për bazë neni 9.4 i LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Stacioni i Autobusave "SH.A. Prishtinë
- 1x1 OE- Telekom i Kosoves.Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.